



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

SYLLABUSI I LËNDËS: METODAT CILËSORE DHE SASIORE NË HULUMTIM

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Metodat Cilësore dhe Sasiorë në Hulumtim
Niveli:	Doktoratë
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	45 h
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri dimëror
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda "Metodat Cilësore dhe Sasiorë në Hulumtim" në programin e doktoratës në Biznes dhe Ekonomi është e dizajnuar për të pajisur studentët me njohuri të avancuara në teknikat dhe metodat e hulumtimit që përdoren për të analizuar dhe interpretuar të dhëna në fushën e ekonomisë dhe biznesit. Lënda mbulon një gamë të gjerë temash, përfshirë: Metodat Cilësore: Hulumtimi cilësor përfshin qasjet dhe metodat për mbledhjen, analizimin, dhe interpretimin e të dhënave jo-numerike. Në këtë pjesë, studentët do të mësojnë për intervistat, fokus grupet, observimin, analiza tematike, dhe përdorimin e softuerëve si <i>ATLAS.ti</i>. për kodimin dhe analizimin e të dhënave cilësore. Studentët do të praktikojnë këto metoda përmes rasteve studimore konkrete dhe do të zhvillojnë aftësi për të interpretuar të dhëna komplekse dhe për të ndërtuar teori bazuar në analiza cilësore. Metodat Sasiorë: Hulumtimi sasior përfshin përdorimin e statistikave dhe metodave të tjera numerike për të analizuar të dhënat. Lënda do të mbulojë teknika të avancuara statistikore, përfshirë analizën e regresionit, modelet statistikore, analiza e korrelacionit dhe tesimi i hipotezave. Studentët do të përdorin softuerë si SPSS dhe STATA për të analizuar të dhënat sasiorë dhe për të zhvilluar aftësi për të interpretuar rezultate statistikore dhe për të nxjerrë përfundime të bazuara në të dhëna.

Qëllimet e lëndës:	Qëllimet kryesore të lëndës "Metodat Cilësore dhe Sasiore në Hulumtim" janë: 1. <i>Pajisja me aftësi të avancuara në hulumtim:</i> Të zhvillojë aftësitë e studentëve në përdorimin e metodave cilësore dhe sasiore për të kryer kërkime shkencore të nivelit të lartë në fushën e biznesit dhe ekonomisë. 2. <i>Zhvillimi i aftësive analitike:</i> Të aftësojë studentët në analizimin dhe interpretimin e të dhënave komplekse duke përdorur softuerë të specializuar si ATLAS.ti, SPSS, dhe Stata. 3. <i>Aplikimi praktik i metodave:</i> Të mundësojë studentët që të zbatojnë teoritë dhe teknikat e mësuara në projekte konkrete hulumtuese, duke integruar metodat cilësore dhe sasiore në studime empirike. 4. <i>Ndërtimi i themelit për kërkime të avancuara:</i> Të përgatisë studentët për zhvillimin e tezave të doktoratës duke u ofruar njohuri të thella mbi metodat e kërkimit dhe aplikimet e tyre në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe biznesit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studenti është në gjendje të: ○ Zotëron kuptimin e thellë të metodologjive cilësore dhe sasiore të hulumtimit dhe mënyrën si ato kontribuojnë në zhvillimin e njohurive në shkencat e biznesit dhe ekonomisë. ○ Aplikon teknika të avancuara të analizës statistikore për të përpunuar të dhëna të mëdha dhe për të gjeneruar rezultate të vlefshme për hulumtimin ekonomik. ○ Analizon të dhëna cilësore duke përdorur teknika si kodimi dhe analiza tematike për të zbuluar modele dhe lidhje të rëndësishme në studimet e biznesit. ○ Vlerëson fuqitë dhe kufizimet e metodave të ndryshme të hulumtimit duke krahasuar rezultatet e studimeve sasiore dhe cilësore dhe duke rekomanduar metodologjinë më të përshtatshme për probleme të caktuara hulumtuese. ○ Krijon modele dhe korniza hulumtuese të personalizuar që ndërthurin metodat cilësore dhe sasiore për të adresuar pyetje komplekse kërkimore në fushën e ekonomisë. ○ Zbaton software bashkëkohorë për analizën e të dhënave cilësore dhe sasiore, duke përfshirë ATLAS.ti, SPSS, dhe STATA, në projektet kërkimore. ○ Sintetizon të dhënat e mbledhura nga burime të ndryshme, duke integruar rezultate nga analizat cilësore dhe sasiore për të nxjerrë përfundime të informuara mbi fenomenet ekonomike. ○ Inicon qasje të reja për analizën e të dhënave cilësore dhe sasiore, duke eksploruar metodat e përparuara të

	hulumtimit për të gjeneruar njohuri të reja dhe të aplikueshme në praktikën e biznesit.		
	o Kordinon projekte kërkimore komplekse duke përdorur metodologji të përziera që përfshijnë elemente të hulumtimit cilësor dhe sasiorë, duke siguruar cilësi të lartë dhe rezultate të vlefshme për politikëbërësit dhe udhëheqësit e biznesit.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	3	9	27
Leximi i literaturës shkencore	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	9	18
Esetë dhe grupet e diskutimit	2	5	10
Përgatitja për provimin final	4	5	20
Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave	3	5	15
Analiza e të dhënave dhe hartimi i punimit hulumtues	5	5	25
Rishikimi/kontrollimi i punimit dhe përgaditja për prezantim	1	5	5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies për lëndën "Metodat Cilësore dhe Sasiorë në Hulumtim" në programin e doktoratës në Biznes dhe Ekonomi bazohet në një qasje të kombinuar teoriko-praktike, e cila synon të pajisë studentët me aftësi të thelluara në aplikimin e metodave hulumtuese.		
	1. Ligjerata interaktive: Ligjeratat do të përfshijnë prezantime teorike të metodave cilësore dhe sasiorë, të mbështetura me shembuj konkretë nga hulumtimet e fundit në fushën e biznesit dhe ekonomisë. Diskutimet në grup dhe analizat e rasteve		

	studimore do të inkurajohen për të stimuluar mendimin kritik dhe shkëmbimin e ideve. 2. <i>Punë Praktike dhe workshop-e</i>: Studentët do të marrin pjesë në workshop-e ku do të praktikojnë përdorimin e softuerëve të ndryshëm si NVivo, SPSS, dhe STATA për analizimin e të dhënave cilësore dhe sasiore. Këto aktivitete do të mbështeten nga detyra të bazuara në raste reale, që do t'u mundësojnë studentëve të zbatojnë njohuritë e tyre në projekte kërkimore konkrete. 3. <i>Prezantime individuale dhe grupore</i>: Studentët do të prezantojnë gjetjet e tyre hulumtuese dhe do të marrin feedback nga kolegët dhe mësimmshënësi. Këto prezantime do të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive për të komunikuar në mënyrë efektive rezultatet e hulumtimit dhe për të reflektuar mbi qasjet metodologjike të përdorura. 4. <i>Mbështetje në hulumtim</i>: Studentët do të kenë mundësi për konsultime individuale me mësimmshënësin për të diskutuar progresin e tyre në hulumtime, sfidat metodologjike që mund të përballen, dhe për të marrë udhëzime për avancimin e projekteve të tyre kërkimore. Kjo metodologji synon të krijojë një mjedis të balancuar të mësimmshënies, ku studentët përfitojnë si nga përvetësimi i njohurive teorike ashtu edhe nga aftësitë praktike të nevojshme për të kryer kërkime të avancuara në biznes dhe ekonomi.
Metodat e vlerësimit:	• Projekti Kërkimor: 30% • Provimi Final: 60% • Pjesëmarrja dhe Diskutimet: 10% Në total, nota përfundimtare do të përbëhet nga këto tre elemente kryesore, duke vlerësuar angazhimin dhe aftësitë e studentit në secilën prej tyre.
Literatura	
Literatura bazë:	▪ Donald R. Cooper & Pamela S. Schindler (2022) – <i>Business Research Methods</i>, McGraw-Hill Irwin. ▪ Creswell, J. W., & Creswell, J. D. (2022). <i>Research Design: Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods Approaches</i>. SAGE Publications, Los Angeles. ▪ Grup Autorësh (2020) – <i>Teknikat Statistikore me Shumë Ndryshore me Aplikim në SPSS, (Botimi i Gjashtë, 2017), 1 – 490.</i> ▪ Miles, M. B., Huberman, A. M., & Saldaña, J. (2020).

	<i>Qualitative Data Analysis: A Methods Sourcebook.</i> SAGE Publications, Los Angeles. Anderson, D. R., Sweeney, D. J., & Williams, T. A. (2022). <i>Quantitative Methods for Business.</i> Cengage Learning, Boston.
Literatura shtesë:	- Bob Matthews dhe Liz Ross, (2010), <i>Metodat e hulumtimit – udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane</i>, Centre for Democratic Education (Qendra për Edukim Demokratik), Tiranë. (Përkthyer nga anglishtja: Majlinda Nishku dhe Ilir Nishku). - Yin, R. K. (2021). <i>Case Study Research and Applications: Design and Methods.</i> SAGE Publications, Los Angeles. - Blunch, N. J. (2021). <i>Introduction to Structural Equation Modeling Using IBM SPSS Statistics and Amos.</i> SAGE Publications, Los Angeles. - Kuckartz, U., & Rädiker, S. (2022). <i>Analyzing Qualitative Data with MAXQDA: Text, Audio, and Video.</i> SAGE Publications, Los Angeles. - Creswell, J. W., & Plano Clark, V. L. (2021). <i>Designing and Conducting Mixed Methods Research.</i> SAGE Publications, Los Angeles.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Sesioni i parë:	Hyrje (Prezantimi i lëndës, metodat e punës dhe vlerësimit) Paradigmat dhe dizajnet e hulumtimit: një analizë krahasuese <i>Diskutimi i bazave filozofike dhe teorike që udhëheqin zgjedhjen e metodave hulumtuese, përfshirë paradigma si pozitivizmi, interpretivizmi dhe pragmatizmi.</i>
Sesioni i dytë:	Metodat cilësore në hulumtim dhe aplikimi i tyre <i>Njohuritë të avancuara të metodave cilësore, përfshirë intervistat, fokus grupet, vëzhgimet dhe analizat dokumentare, dhe përdorimi i tyre në kontekstin e biznesit dhe ekonomisë.</i> Metodat sasiore: modelet e avancuara statistikore <i>Eksplorimi i metodave të avancuara statistikore për analizën e të dhënave sasiore, përfshirë regresionet e shumëfishta, analizën faktoriale dhe modelet strukturore</i>
Sesioni i tretë:	Integrimi i metodave cilësore dhe sasiore <i>Njohuritë dhe praktikët për kombinimin e metodave cilësore dhe sasiore në një studim hulumtues të integruar</i>

	Dizajni eksperimental dhe kuazi-eksperimental në hulumtim <i>Diskutimi i dizajneve eksperimentale dhe kuazi-eksperimentale për testimin e hipotezave në hulumtime të avancuara</i>
Sesioni i katërt:	Analiza tematike dhe kodimi në hulumtimin cilësor <i>Teknikat e avancuara për analizën tematike dhe kodimin e të dhënave cilësore, duke përdorur softuerë si ATLAS.ti.</i> Modelimi ekonometrik në hulumtime të avancuara <i>Aplikimi i metodave ekonometri në hulumtime të avancuara, përfshirë analizat kohore, seritë kohore dhe panelet e të dhënave.</i>
Sesioni i pestë:	Metodat cilësore në hulumtimin e rasteve të studimit <i>Thellimi në metodologjinë e rasteve të studimit, përfshirë dizajnin, mbledhjen dhe analizën e të dhënave</i> Simulimet dhe modelet makroekonomike në hulumtim <i>Përdorimi i simulimeve dhe modeleve makroekonomike për parashikimin dhe analizimin e fenomeneve ekonomike komplekse.</i>
Sesioni i gjashtë:	Analiza e të dhënave të mëdha (Big Data) në hulumtimin sasior <i>Teknikat dhe veglat për mbledhjen, analizën dhe interpretimin e të dhënave të mëdha në kontekstin e biznesit dhe ekonomisë.</i> Metodat cilësore në hulumtimet e ndërveprimit të palëve të interesuara <i>Hulumtimi i metodave cilësore për analizimin e ndërveprimeve dhe marrëdhënieve midis palëve të interesuara në biznes dhe ekonomi.</i>
Sesioni i shtatë:	Metodat e avancuara për matjen e perceptimeve dhe qëndrimeve <i>Hulumtimi i teknikave për matjen e perceptimeve dhe qëndrimeve të individëve dhe grupeve në kontekste organizative dhe tregtare.</i> Etika dhe Integriteti në Hulumtimin Cilësor dhe Sasior <i>Diskutimi i çështjeve etike dhe integritetit në kryerjen e hulumtimeve cilësore dhe sasior, duke përfshirë konfidencialitetin, anonimitetin dhe përgjegjësinë shkencore.</i>
Sesioni i tetë:	Prezentimi i punimeve hulumtuese
Sesioni i nëntë:	Prezentimi i punimeve hulumtuese

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.